



REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2025

Nr.	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa										
01.	10.01.25	Kërkesë për informacion mbi qendrat që ofrojnë shërbime për fëmijë dhe të rritur me AK, numri aktual i përfituesve, raporti gjinor etj.	16.01.25	Numri total i rezidentëve me AK është 165, ndërsa moshën 18 vjeç e kanë mbushur 40 prej tyre. Sipas grupmoshave janë të ndarë në: • 4-6 vjeç – 1 mashkull • 7-10 vjeç – 4 femra, 4 meshkuj • 11-14 vjeç – 7 femra, 6 meshkuj • 15-17 vjeç – 7 femra, 11 meshkuj. Sipas llojit të AK: • AK mendore – 94 nga 165 • AK fizike – 12 • AK shqisore – 4 54 fëmijë janë të diagnostikuar me më shumë se një lloj të aftësisë së kufizuar. Sa prej femijeve rezidente të institucionit tuaj kanë të regjistruar në dosjen personale kujdestar ligjor familjen biologjike apo të afërm dhe sa femije janë nën kujdestarinë të shtetit (Institucionit). <table><tr><th>Grupmosha</th><th>4-6 vj</th><th>7-10 vj</th><th>11-14 vj</th><th>15-17 vjeç</th></tr><tr><td>Numri i rezidentëve femije me familje biologjike apo të afërm si kujdestare ligjor aktive (me</td><td>0</td><td>5</td><td>7</td><td>9</td></tr></table>	Grupmosha	4-6 vj	7-10 vj	11-14 vj	15-17 vjeç	Numri i rezidentëve femije me familje biologjike apo të afërm si kujdestare ligjor aktive (me	0	5	7	9	E plotë	Nuk ka
Grupmosha	4-6 vj	7-10 vj	11-14 vj	15-17 vjeç												
Numri i rezidentëve femije me familje biologjike apo të afërm si kujdestare ligjor aktive (me	0	5	7	9												

[illegible]



				<table><tr><td>Gostime</td><td>1</td></tr><tr><td>Shllak</td><td>1</td></tr><tr><td>Vlorë</td><td>2</td></tr><tr><td>Babice</td><td>1</td></tr><tr><td>Njes administrative nr.4; 11; 2 dhe Pezë</td><td>4</td></tr><tr><td>Pakuqan</td><td>1</td></tr><tr><td>Rajoni 4</td><td>1</td></tr><tr><td>Nikel, rinas</td><td>1</td></tr><tr><td>Njësia administrative Molisht dhe Terpan</td><td>2</td></tr><tr><td>Njësia administrative Teqe; Bathes dhe Bradashesht</td><td>3</td></tr><tr><td>Kënet</td><td>3</td></tr><tr><td>Fier</td><td>3</td></tr><tr><td>Tiranë</td><td>2</td></tr><tr><td>Korçë</td><td>1</td></tr><tr><td>Berat</td><td>1</td></tr></table>	Gostime	1	Shllak	1	Vlorë	2	Babice	1	Njes administrative nr.4; 11; 2 dhe Pezë	4	Pakuqan	1	Rajoni 4	1	Nikel, rinas	1	Njësia administrative Molisht dhe Terpan	2	Njësia administrative Teqe; Bathes dhe Bradashesht	3	Kënet	3	Fier	3	Tiranë	2	Korçë	1	Berat	1		
Gostime	1																																			
Shllak	1																																			
Vlorë	2																																			
Babice	1																																			
Njes administrative nr.4; 11; 2 dhe Pezë	4																																			
Pakuqan	1																																			
Rajoni 4	1																																			
Nikel, rinas	1																																			
Njësia administrative Molisht dhe Terpan	2																																			
Njësia administrative Teqe; Bathes dhe Bradashesht	3																																			
Kënet	3																																			
Fier	3																																			
Tiranë	2																																			
Korçë	1																																			
Berat	1																																			
02.	16.01.25	Kërkesë për informacion mbi numrin e personave me Sindrome Doun, numrin e kujdestarëve të tyre.	16.01.25	Shërbimi Social Shtetëror nuk ka të dhëna të segreguara sipas diagnozës. Statistikat e mbajtura nga Shërbimi Social mbahen sipas kategorive: • PAK Mendor/Fizik • Paraplegji • Verbëri.	E plotë	Nuk ka																														
03.	24.02.25	Kërkesë për informacion mbi shërbimet publike dhe jo publike për moshimin në Shqipëri	28.02.25	Shërbimet sociale për të moshuarit në vend funksionojnë sipas standardeve të miratuara për çdo tipologji shërbimi dhe konkretisht si: shërbime rezidenciale, qendra ditore/ komunitare, asistencë në banesë.	E plotë	Nuk ka																														



			Aktualisht institucionet publike te financuara direkt nga buxheti i shtetit jane gjashtë institucione rezidenciale dhe dy qendra ditore. Institucionet e Përkujdesit Social për të Moshuar, ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës dhe nxitjen e integritit social të tyre. Aktiviteti i institucioneve bazohet në vlerat e humanizmit, përkujdesit, respektit dhe përkushtimit ndaj moshës së tretë. Institucionet e përkujdesit social për të moshuar kanë si qëllim ofrimin e shërbimeve sipas parimeve bazë respektimi dhe garantimi i vlerave dhe personalitetit individual, barazia e mundësive, e drejta për të përfituar, partneriteti, transparenca dhe paanshmëria, pavarësia, integritet shoqëror dhe pjesëmarrje në komunitet, mosdiskriminim. Aktualisht kapaciteti në IPSH për të moshuar rezidencial publik është 332 dhe 85 në dy qendrat polivalente për të moshuar. Kërkesat për marrje shërbimi për të moshuarit në institucion shqyrtohen në Bashkitë që administrojnë IPSH për të moshuar rezidenciale si dhe pranë Shërbimit Social Shtetëror. Rastet shqyrtohen në bazë të ligjit të Shërbimeve Shoqërore në Republikën e Shqipërisë nr121/2016 dhe VKM 518/2018 që përcakton kriteret dhe dokumentacionin për të përfituar shërbim në IPSH rezidenciale. Nga ana e Shërbimit Social Shtetëror rastet shqyrtohen me prioritet në mënyrë që të moshuarit në nevojë të gjejnë mbështetje duke u sistemuar dhe marrë shërbimin e duhur në këto qendra rezidenciale.	
--	--	--	--	--



				Në qendrat ditore për të moshuar ofrohet shërbim për të moshuarit duke ofruar mundësi dhe përkujdesje . Në këto qendra ofrohen shërbime social-, shërndetësore, dhe të moshuarit gëzojnë të gjitha të drejtat e tyre ligjore. Të moshuarit kalojnë ditën në këto qendra në përputhje me interes dhe kërkesat e tyre shoqërore dhe shpirtërore. Pra të moshuarit të ndihën sa më aktiv. Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” çdo bashki ka zhvilluar planin e përkujdesit social, në të cilat janë planifikuar ndërhyrje për ngritje shërbimesh për moshën e tretë me bazë komunitare (shërbime ditore dhe asistencë në familje) si nevojë e evidentuar nga rritja e numrit të kërkesave për shërbime sociale.. Mekanizmi i Fondit Social u ka siguruar mbështetje financiare bashkive për zhvillimin e shërbimeve të munguara në komunitet në bazë të kërkesave dhe nevojave. Kjo ka mundësuar zgjerimin e hartës së shërbimeve sociale për të moshuar në vend me shërbime me bazë komunitare. Ngritja e shërbimeve të reja ka mundësuar ofrimin e shërbimeve me bazë komunitare për të moshuarit si një alternativë më e mirë për ta. Kjo reflekton qëllimin gjithnjë e më tepër të politikave sociale drejt de-institucionalizimit dhe ofrimit të shërbimeve sociale në territor Aktualisht në vend funksionojnë gjithsej 32 shërbime ditore dhe komunitare. Nga këto 6 prej tyre janë shërbime lëvizëse (asistencë në shtëpi) dhe 11 qendra ditore të financuara nga mekanizmi i fondit social.		
--	--	--	--	--	--	--

				Rreth 2722 të moshuar përfitojnë aktualisht shërbime ditore, dhe 1421 të moshuar përfitojnë shërbime të asistencës shtëpiake, dhe lëvizëse komunitare multifunkionale për të moshuarit. Shërbimi Social Shtetëror bashkëpunon me pushtetin vendor duke bashkërenduar planet sociale të hartuara prej tyre dhe duke i nxitur në ngritje shërbimesh të reja për këtë kategori . Gjithashtu monitoron shërbimet e ngritura me fond social në mënyrë që shërbimi të ofrohet në përputhje me standardet e miratuara dhe të jetë sa më cilësor. Sikurse SHSSH trajnon stafet sociale të bashkive në mënyrë që shërbimet sociale të menaxhohen sa më mirë nga ata. <i>Shërbimet në qendrat private i inspekton inspektoriat i punës dhe shërbimeve shoqërore.</i>		
04.	05.03.25	Kërkesë për informacion mbi numrin e jetimëve në Shqipëri, masën e ndihmës sociale dhe numrin e fëmijëve të vendosur në shërbimin e kujdestarisë	19.03.25	Përfitues të Ndihmës Ekonomike të kategorive të veçanta: 1026 Jetimë të cilët nuk janë në institucione. 14 Viktima trafikimi 318 Fëmijë të vendosur në shërbim in e kujdestarisë Përsa i përket ndihmës financiare që përfitojnë kategoria e fëmijëve në kujdestari ajo bazohet në vendimin nr. 149, datë 13.3.2018 ``Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare`` Masa e financimit për familjen kujdestare, për shpenzimet ushqimore për një fëmijë të vendosur në	E plotë	Nuk ka



				kujdestari, është 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj, ndërsa për shpenzimet e ushqimit të një fëmije me aftësi të kufizuara është 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj. Masa e financimit për familjen kujdestare, për një fëmijë të vendosur në kujdestari, është si vijon: a) shpenzime për veshmbathje: 10 000 (dhjetë mijë) lekë në vit; b) shpenzime për shkollimin: 5 000 (pesë mijë) lekë në vit; dhe c) shpenzime të tjera: 10 000 (dhjetë mijë) lekë në vit.		
05.	14.3.25	Kërkesë për informacion mbi numrin e fëmijëve në IPSH në varësi të shërbimit Social Shtetëror për vitin 2020, 2023, 2024, 2025.	21.03.25	Viti 2020 - 229 Viti 2023 -164 Viti 2024 172 Viti 2025 - 173	E plotë	Nuk ka
06.	17.03.25	Kërkesë për informacion mbi familjet që kanë marrë ndihmë financiare, kriteret e përfitimit etj.	28.03.25	Lidhur me kriteret për përfitim nga skema e ndihmës ekonomike, në VKM-në Nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Kreu I, pika 2, gërma (a) përcaktohet se: “përfitojnë ndihmë ekonomike familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme” Lidhur me kriteret për përfitim nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike në Kreun IV, pika 1 të VKM-së Nr. 597/2019 përcaktohet se: “<i>Këshilli Bashkiak miraton në fillim</i>	E plotë	Nuk ka



				të vitit kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese për ndihmë ekonomike, të cilat nuk janë shpalluar përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”. Sipas pikave 5 dhe 7 të po këtij Kreu përcaktohet se, Këshilli bashkiak ka të drejtë të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese të cilat: - Në momentin që do të përzgjidhen nga lista e familjeve, duhet të kenë aplikuar brenda tre muajve të fundit nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar, - Të mos jenë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, - Duhet të jetë kryer paraprakisht vlerësimi social ekonomik në familje nga administratori shoqëror.									
Gjatë muajit Prill 2025 nuk ka pasur kërkesa për informacion													
07.	05.05.25	Kërkesë për informacion mbi numrin e fëmijëve në institucionet e përkujdesit nga viti 2020-2025 dhe buxhetet akorduar institucioneve.	14.05.25		IPSH publik	2020	2021	2022	2023	2024		E plotë	Nuk ka
				1	Shtëpia e fëmijës 0-5 vjeç Tiranë	36	31	30	29	34			
				2	Shtëpia e fëmijës 0-5 vjeç Korçë	19	13	6	3	3			
				3	Shtëpia e fëmijës 0-5 vjeç Vlorë	21	14	10	2	0			
				4	Shtëpia e fëmijës 0-5 vjeç Durrës	18	15	18	20	21			
				5	Shtëpia e fëmijës 0-5 vjeç Shkodër	9	18	17	17	19			

				<table><tr><th>Emërtimi</th><th>Totali i Buxhetit 2024</th><th>Totali i Buxhetit 2023</th></tr><tr><td>Shtëp. Foshnjës Tiranë</td><td>55,771,000</td><td>47,986,000</td></tr><tr><td>Shtëp. Foshnjës Korçë</td><td>15,503,000</td><td>15,433,000</td></tr><tr><td>Shtëp. Foshnjës Shkodër</td><td>21,556,000</td><td>18,597,000</td></tr><tr><td>Shtëp. Foshnjës Durrës</td><td>34,816,000</td><td>31,477,000</td></tr><tr><td>Shtëp. Foshnjës Vlorë</td><td>19,742,000</td><td>20,239,000</td></tr><tr><td>Totali</td><td>147.388.000</td><td>133.732.000</td></tr></table> <table><tr><th>Totali i Buxhetit 2022</th><th>Totali i Buxhetit 2021</th><th>Totali i Buxhetit 2020</th></tr><tr><td>42,010,000</td><td>44,080,000</td><td>43,398,000</td></tr><tr><td>15,590,000</td><td>16,424,000</td><td>15,922,000</td></tr><tr><td>14,860,000</td><td>15,810,000</td><td>16,477,000</td></tr><tr><td>26,880,000</td><td>27,450,000</td><td>27,727,000</td></tr><tr><td>19,180,000</td><td>21,450,000</td><td>20,108,000</td></tr><tr><td>118,520,000</td><td>125,214,000</td><td>123,632,000</td></tr></table>	Emërtimi	Totali i Buxhetit 2024	Totali i Buxhetit 2023	Shtëp. Foshnjës Tiranë	55,771,000	47,986,000	Shtëp. Foshnjës Korçë	15,503,000	15,433,000	Shtëp. Foshnjës Shkodër	21,556,000	18,597,000	Shtëp. Foshnjës Durrës	34,816,000	31,477,000	Shtëp. Foshnjës Vlorë	19,742,000	20,239,000	Totali	147.388.000	133.732.000	Totali i Buxhetit 2022	Totali i Buxhetit 2021	Totali i Buxhetit 2020	42,010,000	44,080,000	43,398,000	15,590,000	16,424,000	15,922,000	14,860,000	15,810,000	16,477,000	26,880,000	27,450,000	27,727,000	19,180,000	21,450,000	20,108,000	118,520,000	125,214,000	123,632,000		
Emërtimi	Totali i Buxhetit 2024	Totali i Buxhetit 2023																																														
Shtëp. Foshnjës Tiranë	55,771,000	47,986,000																																														
Shtëp. Foshnjës Korçë	15,503,000	15,433,000																																														
Shtëp. Foshnjës Shkodër	21,556,000	18,597,000																																														
Shtëp. Foshnjës Durrës	34,816,000	31,477,000																																														
Shtëp. Foshnjës Vlorë	19,742,000	20,239,000																																														
Totali	147.388.000	133.732.000																																														
Totali i Buxhetit 2022	Totali i Buxhetit 2021	Totali i Buxhetit 2020																																														
42,010,000	44,080,000	43,398,000																																														
15,590,000	16,424,000	15,922,000																																														
14,860,000	15,810,000	16,477,000																																														
26,880,000	27,450,000	27,727,000																																														
19,180,000	21,450,000	20,108,000																																														
118,520,000	125,214,000	123,632,000																																														
08.	10.06.25	Kërkesë për informacion mbi numrin e fëmijëve në Qendrën e Zhvillimit Vlorë, dinamikat, buxhetin akorduar institucionit etj.	18.06.25	Pranë Qendrës së Zhvillimit Vlorë aktualisht marrin shërbim 29 përfitues. Qendra e Zhvillimit Vlorë ka një kapacitet prej 29 përfitues. Që nga viti 2015 e në vazhdim, numri i rezidentëve ka variuar të jetë 27-29 përfitues çdo vit.	E plotë	Nuk ka																																										



			Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 4 kthime në familjet biologjike: (2019, 2020, 2023). Në bazë të VKM Nr. 88 datë 25.10.2011 organika e Qendrës së Zhvillimit Vlorë është e përbërë nga 18 punonjës. Gjithashtu janë shtuar edhe 3 figura të profesionistëve që punojnë part time. Në varësi të nevojave të institucionit për të ofruar një shërbim sa më cilësor, Bashkia Vlorë plotëson organikën e institucionit me staf shtesë. Buxheti i akorduar:																																					
			<table><tr><th>Viti</th><th>Paga 600</th><th>Sigurime 601</th><th>Shpenzi me Operative 602</th><th></th></tr><tr><td>2020</td><td>13,268,000</td><td>2,300,000</td><td>7,700,000</td><td></td></tr><tr><td>2021</td><td>13,330,000</td><td>2,280,000</td><td>7,000,000</td><td></td></tr><tr><td>2022</td><td>11,640,000</td><td>1,980,000</td><td>6,400,000</td><td></td></tr><tr><td>2023</td><td>15,495,000</td><td>2,600,000</td><td>7,040,000</td><td></td></tr><tr><td>2024</td><td>18,100,000</td><td>3,031,000</td><td>8,100,000</td><td></td></tr><tr><td>2025</td><td>18,445,000</td><td>3,080,000</td><td>7,800,000</td><td></td></tr></table>	Viti	Paga 600	Sigurime 601	Shpenzi me Operative 602		2020	13,268,000	2,300,000	7,700,000		2021	13,330,000	2,280,000	7,000,000		2022	11,640,000	1,980,000	6,400,000		2023	15,495,000	2,600,000	7,040,000		2024	18,100,000	3,031,000	8,100,000		2025	18,445,000	3,080,000	7,800,000			
Viti	Paga 600	Sigurime 601	Shpenzi me Operative 602																																					
2020	13,268,000	2,300,000	7,700,000																																					
2021	13,330,000	2,280,000	7,000,000																																					
2022	11,640,000	1,980,000	6,400,000																																					
2023	15,495,000	2,600,000	7,040,000																																					
2024	18,100,000	3,031,000	8,100,000																																					
2025	18,445,000	3,080,000	7,800,000																																					



				Shërbimi Social Shtetëror akordon çdo fillim viti kalendarik fondet për pagat (600), sigurimet shoqërore (601) dhe shpenzimet operative (602) për Qendren e Zhvillimit Vlorë. Fondi për pagat dhe sigurime shoqërore përcaktohet në bazë të organikës që ka Qendra e Zhvillimit Vlorë, ndërsa fondi për shpenzime operative administrohet nga vetë qendra ku shpenzimet kryesore shkojnë për ushqime, veshmbathje, medikamente dhe produkte të higjienës personale, aktivitete edukative etj. Gjithashtu, një pjesë e buxhetit përdoret për shpenzime të tjera operative të domosdoshme për funksionimin normal të institucionit, siç janë energjia elektrike, furnizimi me ujë, ngrohja, mirëmbajtja e ambienteve dhe blerja e materialeve të ndryshme të konsumit të përditshëm. Pranimet në institucion bëhen në zbatim të VKM Nr. 518, datë 04.09.2018, “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe private, të përkujdesit shoqëror”. Kërkesat për pranim në institucion vijën nga njësitë administrative sipas VKM të sipërcituar. Sipas informacionit të grumbulluar nuk ka pasur raste të cilat janë refuzuar për pranim në insitucion.		
--	--	--	--	--	--	--



				Sa i përket restaurimit të fundit të godinës, ai është realizuar në vitin 2023, në bazë të një marrëveshjeje mes Bashkisë Vlorë dhe organizatës UNDP.		
09.	10.06.25	Kërkesë për informacion mbi qendra e zhvillimit në Shqipëri, moshat që trajtojnë, kapacitetet etj.	19.06.25	Në rang kombëtar në vendin tonë janë 6 qendra zhvillimi që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuar. Qendrat e Zhvillimit ndodhen në Shkodër, Tiranë, Durrës, Vlorë, Berat, Korçë. Institucionet e përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar ofrojnë shërbime afatgjatë për fëmijët pa kujdes prindëror deri në moshën 21 vjeç. Për shkak se një pjesë e përfituesve janë braktisur nga familjarët e tyre, këto qendra trajtojnë edhe përfitues mbi moshën 21 vjeç. Kryesisht këta përfitues marrin shërbime në qendrën e zhvillimit Korçë dhe Shkodër. Shërbimet që ofrohen janë: 1. Shërbime social-psikologjike 2. Strehim 3. Terapi zhvillimi 4. Terapi okupacionale 5. Shërbime mjekësore Pranimet nuk bazohen në protokolle mjekësore, pasi qendrat nuk janë institucione shëndetësore, por ofrojnë shërbime për aftësimin dhe riintegrimin e	E plotë	Nuk ka

			personave me aftësi të kufizuar, të cilëve familjet biologjike ose kujdestarët ligjor nuk mund t'u ofrojnë kujdes për arsye të ndryshme sociale. Sistemimi i tyre pranë këtyre qendrave bëhet sipas VKM Nr 518 datë 04.09.2018, “Për përcaktimin e kritereve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe private, të përkujdesit shoqëror”. Koha e qëndrimit përcaktohet në bazë të planit individual të kujdesit, të hartuar nga specialistët e institucionit dhe vlerësimeve sociale-ekonomike të kryera nga punonjësit e bashkive. Aktualisht në këto qendra marrin shërbime edhe përfitues të moshës mbi 21 vjec të cilët kanë një kohë qëndrimi të gjatë për shkak se një pjesë e tyre janë braktisur nga familjet biologjike. Kapaciteti i secilës qendër është: <table><tr><th>Nr</th><th>Institucioni</th><th>Kapaciteti</th></tr><tr><td>1</td><td>Qendra e Zhvillimit Tiranë</td><td>28</td></tr><tr><td>2</td><td>Qendra e Zhvillimit Durrës</td><td>45</td></tr><tr><td>3</td><td>Qendra e Zhvillimit Shkodër</td><td>45</td></tr><tr><td>4</td><td>Qendra e Zhvillimit Korçë</td><td>38</td></tr><tr><td>5</td><td>Qendra e Zhvillimit Vlorë</td><td>29</td></tr><tr><td>6</td><td>Qendra e Zhvillimit Berat</td><td>30</td></tr></table> Numri i përfituesve gjatë 5 viteve të fundit është 47 përfitues, si dhe numri i atyre nën 18 vjeç është po 47 përfitues. Përfituesit janë trajtuar me diagnoza të	Nr	Institucioni	Kapaciteti	1	Qendra e Zhvillimit Tiranë	28	2	Qendra e Zhvillimit Durrës	45	3	Qendra e Zhvillimit Shkodër	45	4	Qendra e Zhvillimit Korçë	38	5	Qendra e Zhvillimit Vlorë	29	6	Qendra e Zhvillimit Berat	30		
Nr	Institucioni	Kapaciteti																								
1	Qendra e Zhvillimit Tiranë	28																								
2	Qendra e Zhvillimit Durrës	45																								
3	Qendra e Zhvillimit Shkodër	45																								
4	Qendra e Zhvillimit Korçë	38																								
5	Qendra e Zhvillimit Vlorë	29																								
6	Qendra e Zhvillimit Berat	30																								



				ndryshme të shëndeti mendor të vlerësuar sipas KMCAP-it dhe qendrave komunitare të shëndetit mendor. Sistemimi i përfituesve bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në VKM Nr. 518, datë 04.09.2018, dhe dokumentacioni përgatitet nga punonjësit socialë të njësive administrative dhe përcillet pranë Drejtorive Rajonale të SHSSH ose Drejtorive Sociale të bashkive. Qendrat komunitare të shëndetit mendor dhe mjeku i familjes bashkëpunojnë me punonjësin social në menaxhimin e rasteve dhe plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për sistemimin e tyre në Qendrat e Zhvillimit. Gjithashtu, bazuar në planin individual të kujdesit dhe diagnozën përkatëse për secilin përfitues, Qendrat e Zhvillimit bashkëpunojnë me Qendrat Komunitare të Shëndetit Mendor dhe mjekun e familjes për rishikimin dhe vlerësimin e situatës së tyre shëndetësore.		
10.	18.6.25	Kërkesë për informacion lidhur me procedurat e rekrutimit, numrin e punonjësve të SHSSH, punonjësit e përkohshëm etj.	23.6.25	Shërbimi Social Shtetëror ka punësuar staf të përkohshëm. Punësimi është realizuar në përputhje me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i RSH”, i ndryshuar, si edhe në zbatim të Vkm nr. 19, datë 19.01.2025 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme në njësitë e qeverisjes qendrore”. Shërbimi Social Shtetëror prej vitit 2022 nuk është më në Shërbimin Civil, për rrjedhojë aplikohen dispozitat e Kodit të Punës. Një dosje rekrutimi	E plotë	Nuk ka



			përmban: shpallje, listë të kandidatëve, proces-verbale të vlerësimit dhe vendim përfundimtar. Për të parë shpalljen dhe listën e kandidatëve të kualifikuar në një nga procedurat e fundit janë mund të vizitoni linkun: https://www.sherbimisocial.gov.al/shpallje-nr-360-pozicioni-specialist-sektori-juridik-drejtorja-e-sherbimeve-te-brendshme-dpshssh-tirane/ Ndërkohë, përsa i takon vlerësimit me pikë të kandidatëve, dhënia e këtij informacioni kufizohet nga Neni 17, Pika, 1, c, mbi të dhënat private. Numri aktual i punonjësve të institucionit është 53, të gjithë jashtë shërbimit civil. 53 punonjës janë në strukturë dhe 8 janë të punësuar me kontratë të përkohshme. Për konkursin publik më të fundit të përfunduar për një pozicion jo drejtues: https://www.sherbimisocial.gov.al/shpallje-nr-360-pozicioni-specialist-sektori-juridik-drejtorja-e-sherbimeve-te-brendshme-dpshssh-tirane/ Është publikuar në faqen zyrtare të institucionit dhe në APP. Dokumentet që kandidatët duhej të dorëzonin në momentin e aplikimit janë:		
--	--	--	---	--	--



				1. Kërkesën për aplikim; 2. Jetëshkrimi (CV); 3. Fotokopje të diplomës dhe listës së notave; 4. Fotokopje të librezës së punës; 5. Fotokopje të kartës së identitetit; 6. Dëshmi penaliteti ose vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore; 7. Çertifikatë familjare; 8. Vërtetim banimi; 9. Raport mjekësor që vërteton gjendjen shëndetësore; 10. Certifikata të kualifikimeve; 11. Referenca pune. Të gjitha dokumentet dorëzohen nga vetë kandidati. SHSSH nuk ka pasur konkurse për pozicion drejtues të lartë.		
11.	19.6.25	Kërkesë për informacion lidhur me statistikat për PAK intelektualë, sipas gjinisë, moshës, dhe statusit të përfitimit nga shërbimet.	1.7.25	https://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2025/07/Kthim-pergjigje.xlsx	E plotë	Nuk ka
12.	21.7.25	Kërkesë për informacion lidhur me statistikat për personat para-tetraplegjikë, pagesat e ndihmës personal dhe paketës higjieno-sanitare etj.	21.7.25	Numri i personave përfitues të Statusit të Para-Tetraplegjisë në rang vendi është 5589. Numri i personave përfitues të Statusit të Para-Tetraplegjisë që trajtohen me ndihmës personal është 5550, ndërsa numri i personave përfitues të Statusit të Para-Tetraplegjisë që trajtohen me paketë higjieno-sanitare është 5472. Pagesa e paketës higjieno-sanitare është rritur nga 16.000 lekë në 20.000 lekë në zbatim të Vkm nr. 744, datë 4.12.2024 “Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr.78, datë 7.2.2007 “Për masën, kriteret dhe procedurat	E plotë	Nuk ka



			e përfitimit të një pakete të veçantë higjiëno-sanitare për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë”. Pagesa e ndihmësit personal të personave para-tetraplegjikë është 12.315 lekë bazuar në Urdhrin nr. 312, datë 25.09.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH. Përsa i takon pyetjes suaj mbi pagesën e kontributeve për ndihmësit personalë të personave para-tetraplegjikë sqarojmë se në zbatim të Vkm nr. 182, datë 26.2.2020, kreu III, pika 8 “<i>Periudha e shërbimit si ndihmës personal për personat e përcaktuar në shkronjën "a", të nenit 8 të ligjit 57/2019, “Për Asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të cilët nuk janë ekonomikisht aktivë dhe nuk përfitojnë të ardhura nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, vlerësohet periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni, barrë lindje, akisidenti në punë, sëmundje profesionale dhe sigurimi shëndetësor. Kontributet paguhen në bazë të pagës minimale, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të detyrueshëm shoqëror, dhe përballohen nga buxheti i shtetit</i>”.		
Gjatë muajit Gusht 2025 nuk ka pasur kërkesa për informacion					